

Policia Bashkiake në zbatim të kompetencave të saj dhe në përkrahje të politikave të zhvillimit të Bashkisë në harmoni të plotë me strukturat e policisë së rendit, drejtoritë e tjera në bashki dhe duke kërkuar në çdo rast mirëkuptimin e qytetarëve gjatë vitit 2011 ka kryer këto detyra:

1. Gjatë këtij viti Policia Bashkiake ka qënë në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike.
2. Policia Bashkiake ka kryer të gjitha detyrat e dhëna nga Kryetari i Bashkisë.
3. Gjatë gjithë vitit policia ka punuar për largimin e ambulantëve nga trotuaret dhe ambientet e tjera publike.
4. Policia Bashkiake ka punuar intensivisht për normalizimin dhe disiplinimin e parkingjeve publike në qytet, duke aplikuar masat shtrënguese të parashikuara në Kodin rrugor.
5. Policia Bashkiake ka bashkëpunuar vazhdimisht me Drejtorinë e Shërbimeve Publike sipas kërkesave;
 - Gjithashtu gjate vitit ka pas bashkepunim me sektorin veterinar, për të garantuar mbrojtjen e ambjenteve tregëtare nga ndotjet e ndryshme dhe në moslejimin e tregëtimit të produkteve ushqimore në kushte të papërshtatshme sipas konstatimit të bërë nga specialistët e fushës;
6. Bashkëpunim të vazhdueshëm gjatë gjithë vitit ka patur me Inspektoriatin Ndertimor për shëmbjen e ndërtimeve pa leje.
7. Policia Bashkiake gjatë gjithë vitit ka bashkëpunuar me të gjitha drejtorite e aparatit sipas kërkesave dhe nevojave të tyre.
8. Janë ngritur grupe pune për eleminimin e kafshëve dhe qenve endacake nga rrugët kryesore të qytetit gjatë natës.
9. Gjatë verës janë marrë masa për sezonin turistik në ruajtjen e qetësisë publike nga ndotjet akustike.
10. Policia Bashkiake ka qënë e pranishme në të gjitha aktivitetet kulturore-artistike të zhvilluara në qytetin e Lezhës për mbarëvajtjen e tyre si dhe në ruajtjen e rëndit dhe të qetësisë.
11. Ka qënë e pranishme dhe në ndeshjet e zhvilluara në stadiumin “Beslidhja ” për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë.